

Nga Ditari i Klara Budës: 21 Nentor 2012

Vizita ime e parë në Kalabri

Klara Buda*

shkrimtare, eseiste, gazetare

Na prisnin në Bashkësinë Arbëreshe të Frasnitës për nder të 100vjetorit të pamvarësisë së Shqipërisë këtë të mërkurë 21 nentor...

Bëja pjesë në delegacionin zyrtar të Ministrisë të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, ndaj edhe një eskortë na shoqëroi rrugëve të Romës e na evitoi ngarkesën e daljes nga kryeqyteti italian për të na lënë më pas në autorutën drejt Kalabrisë në kaprociet e qarkullimit vetëm një veturë nga pas...

U nisëm nga Roma në orën 06:30 sipas parashikimit, por shoferi duket se humbi një nga daljet e autostradës që duhet të merrte dhe kështu u detyruam të hynim në Napoli. Në të kundërt të pjesës tjetër te grupit që e konsideroi kete humbje kohe, une jo vetëm që nuk u mërçizta, po u kënaqa fshehtas pasi nuk kisha pasur rast të kaloja ndonjëherë në këtë qytet kaq të komentuar si qendër e një mbretërie me vete...një rrugë në anë e së cilës dukeshin shenjat e mbretërisë në fjalë dhe imazhe të ngjashme me mbretëri të tjera që më ishin më familjare.

Kishim tanimë disa orë në rrugë dhe afër mesditës i telefonuan disa herë Ambasadorit shqiptar e ky, po aq herë i kërkoi interlokutorit falje për vonesën. Pas një copë here Ambasadori telefonoi serish e konfirmoi: Jemi aty për 10 minuta, pasi vërtet iu duk se mbrirëm, por vetëm pas pak e kuptoi se ndodheshim ende larg e nuk do mund të mbërrinim sipas premtimit...

Tanimë kishim hyrë në një rrugë fshati plot dredha dhe vetura e policisë italiane e uli shpejtësinë por, në të kundërt, karabinieri që qëndronte në krah të shoferit e levizte gjithnjë e më shpejt tabelën sa herë që ndonjë veturë hynte para veturës sonë duke e ndarë nga ajo e karabinierëve. Ky i fundit (Karabinieri) nxirrte tabelën me një rreth të kuq dhe e tundte egërsisht e sakaq vetura përballë ndalonte e na hapte rrugën. Ky akt u bë më i shpeshtë tek filluam të ngjiteshim rrugën për në Frasnitë. Kur vetura e karabinierëve kryqëzonte ndonjë veturë përballë nesh, kjo e fundit ndalonte në vend si ta ngrinte një shkop magjik...Dukej se Shën Pietri ishte shfaqur duke marrë një pamje tjetër në akord me shenjat e qarkullimit rrugor...

Në hyrje të bashkisë, na priste një grup që dukej se kishte kohë me sytë të ngulur nga ora ndaj dhe Ministri i Punëve të Jashtme, se bashku me delegacionin nga Shqiptarë, e shoqëruan shpejt në sallën e bashkisë dhe pa vonesë nisi një ceremoni e thjeshtë, por ku njerzit u çelën e u gëzuan dukshëm... Në një ulje të rastësishme - nuk kishte protokoll - unë u gjënda në krahun e një mustaqebardhi që shkruante me shpejtësi pjesën e fundit të atij, që, siç do ta kuptoja më vonë, ishte fjalimi i drejtorit të Jetës Arbëreshe për këtë pritje...Mësova më pas se nuk ishte askush tjetër por Augustin Giordano, për të cilin kisha lexuar: i nipi

Emanuilli-t, autorit të "Fjalorit t'Arbëreshvet t'Italisë" - e që ai e quante, i thoshte lalë-dajë? - dhe i vëllai i senatorit Vasil Giordano, të pranishëm. Augustini Giordano përshëndeti të porsaardhurit e citoi e lëvdoi ata (*frasnjtë e purçilotë, ndr.*) që qenkeshin flamurtarë të perdorimit të arbërishtes, një prej të cilëve, e bile nga më të zjarrtët, që ai vetë. Ndërkohë një papas mjekërbardhë, Anton Trupo, fliste italisht për shqiptarinë. Tek e dëgjoja papasin, u përpoqa të imagjinoj se si do të tingëllonte arbërishtja e tij, ndërkohe që nuk mund të harroj sa bukur e me një muzikë të re, të panjohur për mua, e fliste arbërishten Augustin Giordano. E apasionuar pas ikonave, unë, në shoqërinë e drejtorit të muzeut, shkova dhe vizitova Muzeun e artit bizantin shumë të pasur me ikona bizantine. Vizita e muzeut nuk ishte në program për mungesë kohe. Duke bërë këtë "vizitë in inkonjito" humba një pjesë të koncertit të fëmijëve që kishte filluar ndërkohë. Ishte një mrekulli kjo shfaqje, kori i tyre, përgatitur nën kujdesin e Zonjës Kamodeka, Drejtoreshe e Shkollës "Ernest Koliqi". Në tryezën e shtruar në një lokal malor të Vakarcit Arbëresh, u ndodha larg prej A. Giordanos, por në krah të kryetarit të komunës së Frasnitës, Francesko Pellikano, i cili gjithashtu që i lumtur tek fliste arbërisht. Keshilla e tij e vyer - mos i ha makaronat, në festa ne shërbejmë plot tre lloj të ndryshme të tyre dhe nuk ngelet me vend për gjë tjetër - më ndihmoi që të të mund të shijoj edhe mishin e qengjit, të pjekur me aq art. E ku ka tryezë të mirë shqiptare pa mish qengji! Por le të jem e sinqertë deri në fund: personalisht mua nuk pëlqen ta shoh kur i therin qengjat dhe aq më pak të gezohem kur i bëjnë kurban në publik!

Nga kjo vizitë e parë në Kalabri kam si kujtim të vyer një ikonë ortodokse të Shënmërisë të punuar nga një artiste në Romë, një roman të Carmine Abate-s dhe një shishe vaj ulliri nga toka ku u ngulën Arbëreshët, por mbi të gjitha mes këtyre njerëzve ndjeva një respekt dhe një dashuri të lashtë pesë qind vjeçare...

* Klara Buda është shkrimtare, eseiste dhe gazetare. Pas studimeve universitare për letërsi moderne dhe të krahasuar në Sorbonë, Paris IV, ajo ndryshon drejtimin fillestar - atë të mjekësisë veterinarë. Më pas pranohet në Ecole Pratique des Hautes Etudes, në degën metoda të historisë, arkeologjisë dhe histori arti. Në vitin 1996, nën drejtimin e albanologut Christian GUT, mbrojtë Diplome d'Etude Approfondi në histori arti, duke u bërë kështu e para shqiptare e diplomuar nga ky universitet prestigjioz. Ajo ka perkthyer në frengjisht novelen Fshati im e pi rakine të Mitrus Kutelit dhe ka mbrojtur tezen me një biografi letrare të ketij autori. Paralelisht me